REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR**

Nr.1361/9 prot	Elbasan, më 28.05.2026

**VENDIM**
**Nr. 6 date 28.05.2026**

## "PËR SHTYRJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR ANËTAR TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE TË FAKULTETEVE NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT"

Në mbështjetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si dhe në zbatim të nenit 11 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Këshillin Studentor të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" duke qenë se brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 3 date 14.05.2026 të KIZS-së nuk janë paraqitur kandidatura të mjaftueshme nga Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Humane, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve Studentore (KIZS), në mbledhjen e zhvilluar më datë 28.05.2026,

**VENDOSI:**

1. Të shtyjë procesin e kandidimit për anëtarë të Komisioneve Zgjedhore Studentore të Fakulteteve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" si më poshtë:
   - Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë;
   - Fakultetit të Shkencave Humane.
2. Afati për paraqitjen e kandidaturave fillon më datë 28.05.2026 dhe përfundon më datë 02.06.2026.
3. Kandidatët e interesuar të dorëzojnë kërkesën për kandidim pranë zyrës së Protokoll Arkivës të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
   Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR**

**Kryetar**

Elisa Dleshi

| **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** |
|---|---|---|---|
| Erjola Pepa | Paula Tabaku | Ranja Suka | Hyrmet Karaj |

**Sekretar:** Erjola Pepa